



### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më  
19.08.2019, e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkyrjetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Ylli Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Suzan Kika, e pavarur, Bukurie Canolli (AAK), Fikneta Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA) dhe Rifat Deri (AKR-AA).

**Munguan:** Bashkim Beha (PSD), Arbër Vokrri (LVV), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha (AAK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Uran Ismaili (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

**Të pranishëm ishin edhe drejtoret e drejtive të Komunës, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së dhe pronarët e qoshqeve të Komunës së Prishtinës.**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.  
Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

**1. Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e vendosjes së qoshqeve në Komunën e Prishtinës.**

**Kryesuesi hapi diskutimin**

**Egzon Azemi** tha se duke pasur parasysh reagimin e Agjencisë Kosovar të Konkurrencës dhe reagimin e anëtarëve të Kuvendit që të rishikohen kritereve e ankandit të qoshqeve të qytetit, Komuna vendosi t'i shpërfillë kërkesat pikërisht kur Kuvendi zyrtarisht është në pushim, ajo tinëzisht e rikthen këtë ankand me kritere diskriminuese.

Komuna po thirret në veprime ligjore, por fillimi si mund të funksionoj një Komision i tillë, ku njëri nga anëtarë jep dorëheqje, anëtarin tjetër e shkarkoi grupi që e propozoi, ndërsa anëtar i Shoqërisë civile, z. Allen Metaj, e njoftoi ekzekutivin, që nga fillimi i procesit, se ai nuk është ekspert i kësaj fushe, e as nuk do të marrë pjesë në mbledhjet e këtij Komisioni.

Tendenca për t'i kontrabanduar këto kioska është më e rëndësishme sesa legjitimiteti i këtij Komisioni. Edhe nëse Kuvendi veproi gabimisht herën e parë, a nuk do të duhej që kjo pikë të diskutohej përsëri në Kuvend, a nuk do të duhej që një komision i plotë mori vërejtje nga Kuvendi dhe AKK-ja, dhe pastaj të vazhdohet i njëjtë proces me gjysmën e Komisionit. Vetëm ky fakt është i mjaftueshëm, që të gjithë ne ta kuptojmë që ky ankand është i minuar dhe çështja më e rëndësishme për ekzekutivin është tendenca për të përfituar dy apo tri biznese.

Duke pasur parasysh të gjitha këto fakte, bëj thirrje që sot të votoni kërkesën për tërheqjen e Vendimit të vitit 2017, për dhënen e qoshqeve në shfrytëzim.

**Fadil Gashi** tha se grupi GP i AAK-së do t'i përkrahë këta qytetarë në zgjidhjen e kërkesave të tyre.

**Agim Gashi** theksoi se në seancën a kaluar bashkërisht, të gjitha grupet e këshilltarëve të partive politike, u harmonizuam që ta stopojmë procesin dhe të shtyjmë zhvillimin e atij procesi, duke fituar kohë në hapësirë, për të balancuar interesat e mundësisë konkurruese edhe të këtyre grupeve të interesit. Nëse duhet të zgjerohet ky projekt, ka hapësirë të mjaftueshme, ai mund të zgjerohet edhe pa u dëmtuar interesat e këtyre, dhe ka shumë alternativa, të cilat kanë mundur të diskutohen me grupet parlamentare, me komisionin përkatës dhe me grupet e interesit, për të pasur mundësi që t'u krijojmë kushtet të gjithëve që të participojmë në zhvillimin e asaj veprimtarie.

Ne nuk jemi pengesë e zhvillimit të kësaj fushe. Është e vërtetë që ka nevojë të ndryshojë dizajni, të ndryshohen shërbimet, të ofrohet cilësi më e mirë në shërbime, të rregullohet ambienti ku zhvillohet ajo veprimitari, të humanizohet ai ambient dhe të duket me të vërtetë një ambient qytetar në kryeqytetin tonë.

Në emër të Grupit parlamentar, propozoj që ky Kuvend të anulojë Vendimin nr. 01-360/110074230/17, të datës 03.04.2017, për dhënen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe, me lokacionin sipas planit përvendosjen e tyre.

**Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se në vitin 2017 ky Kuvend ka vendosur me i dhënë 36 qoshqe në komunën e Prishtinës me procedurën e dhënieve në shfrytëzim, me qëllim të ndryshimit të situatës që e kemi sot. Dihet se ato qoshqe nuk janë të rregulluara ashtu si duhet, nuk janë higjenike, dhe janë pa kontratë që nga viti 2012.

Sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ligji e jep vetëm një kriter, çmimin më të lartë. Pra, nuk është kjo procedurë e prokurimit, kjo është procedurë që ne duhet me i dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vjet, për çmimin më të lartë të ofruar.

**Shefki Gashi** ngriti një shqetësim lidhur me përfoljen rreth dorëheqjes së tij nga anëtarë i Komisionit për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim, në mbledhjen e kaluar, duke cekur se, anëtarin e komisionit e tërheq vetëm ai që e ka votuar, pra Kuvendi, dhe nuk mundet asnjëri nga anëtarët e Kuvendit të flasë në emër timin dhe të më tërheq nga komisioni. Këtë propozimvendim nëse do ta votojë GP i LDK-së, do ta votoj edhe unë.

**Leutrim Retkoceri** tha se Partia demokratike e Kosovës është e shqetësuar pas publikimit të dytë për dhënien në shfrytëzim të kioskave, pa konsultim dhe pa përfillur mirë Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës për dhënien e kritereve, që u jap mundësi të gjithë qytetarëve të Prishtinës të aplikojnë barabartë në këtë konkurs.

Publikimi i njoftimit për dhënien e kioskave në shfrytëzim në këtë formë, tregon se me këtë temë po bëhet pazar shumë politik.

Nëse ne shkojmë me shfuqizimin e vendimit të vitit 2017, po ashtu si GP kërkojmë edhe shkarkimin e Komisionit për dhënie në shfrytëzim të pronës publike komunale. Nëse ky komision vazhdon në formën e tillë me qenë komision vlerësues pa i konsultuar qytetarët, nuk është më ai komision vlerësues, ai është komision i grupeve të vogla.

**Suzan Kika** u shpreh se është e padrejtë që këta njerëz të hidhen në rrugë për t'ia plotësuar egon dikujt tjetër. Ne duhet pasur parasysh se shumica e pronarëve të kioskave janë në moshë të rritur dhe se tregu i punës nuk i pranon fare. Në rast se do të niseshin nga vetvetja, sigurisht se do të merreshin vendime të drejta.

**Eman Rahmani** theksoi se fakti dhe mënyra se si është shpallur ky ankand edhe në rastin e parë, ku kanë vendosur kriterë milionëshe të qarkullimit për me qenë përfitues, tregon saktë qëllimin se kujt dhe si duhet t'i jepen këto kioska.

Edhe ankandi i dytë ia pamundëson secilit prej këtyre shfrytëzuesve me aplikuar në mënyrë individuale, për shkak të qarkullimit që e bëjnë si biznese të vogla.

Andaj, është mirë që ne të gjithë të votojmë për anulimin e këtij kriteri dhe t'u mundësojmë atyre pronarëve që të punojnë dhe të mos bëhen raste sociale, për shkak se ky është një interes i përgjithshëm.

**Fiknete Bejta** u shpreh se duke pasur parasysh kriteret e konkursit, ne kemi konstatuar se ato kriterë janë diskriminuese, andaj në emër të GP të AAK-së, vlerësojmë që duhet të anulohet vendim i vitit 2017 për shfrytëzimin e këtyre kioskave, dhe të respektohen në tërsi edhe rekondimet a Autoritetit të konkurrencës, edhe të ligjeve në fjalë. Prandaj, çdo kufizim ligjor edhe në çmime më të larta, edhe mos respektimin e kritereve tjera bazë, është diskriminues dhe nuk i respekton të drejtat e njeriut në Komunën e Prishtinës.

**Vlora Dumoshi** shprehu mendimin se këtyre pronarëve të qoshqeve duhet t'u vazhdohen kontratat, sepse, në të kundërtën, Komunës së Prishtinës do t'i shtohen edhe më se 300 raste në asistencë sociale, andaj këtë vendim që sot duhet ta shfuqizojmë.

Ajo u shpreh e pajtimit edhe me parafolësin, z. Retkoceri, që të shkarkohet edhe Komisioni për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim.

*Lidhur me shkarkimin e Komisionit për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim, kryesuesi dha një sqarim, duke cekur se për këtë mbledhje të jashtëzakonshme për diskutim kemi vetëm një pikë dhe nuk mundemi që rendit të ditës t'i shtojmë pika tjera.*

**Drilon Pireva** tha se në seancën e kaluar ne si grup i asamblistëve, kemi kërkuar që kriteret të cilat janë vënë në këtë ankand për dhënie në shfrytëzim, të rishikohen, të mundësohet dhe zgjerohet konkurenca përfitimin e këtyre kioskave. Shpresoj që komisioni ka marrë për bazë të gjitha rekomandimet tona si Kuvend, për të cilën jemi pajtuar edhe me dy grupet e asamblistëve në takimin e fundit. Andaj, propozoj që ne të gjithë së bashku t'u ndihmojmë këtyre njerëzve, mos t'i ftojmë njerëzit ta shfrytëzojnë pronën publike paligjshëm. **Migjen Shala** tha se pjesa dërmuese e këtyre pronarëve, shfrytëzuesve, janë raste sociale, kështu që ne jemi në shërbim të qytetarëve dhe duhet të bëjmë zgjidhjen e këtyre rasteve. Në bazë të kontratave që kanë shfrytëzuesit, ka mundësi me iu vazhduar kontrata, me mundësi vazhdimi, dhe ne duhet tu bëjmë një zgjidhje këtyre shfrytëzuesve të qoshqeve. Në bazë të diskutimeve, dyshoj se në këtë çështje fshihet diçka, ndoshta ndonjë Pazar, që do të jetë i dëmshëm për pronarët e qoshqeve.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë drejtoret, Genc Bashota dhe Ardian Olluri.

**Hafiz Krasniqi** u shpreh se nuk mundemi me e justifikuar mos punën edhe mos zbatimin e ligjit nga Komuna e Prishtinës, që e lejon shfrytëzimin e pronave kujt i tekët edhe si t'i tekët. Në rast se skadon kontrata, a duhet dikush me i përcjellë ato?! Në momentin që i kalon kontrata, duhet të njoftohet pala edhe në momentin që pala nuk i përgjigjet vendimit të Komunës, ke të drejtë me marrë masa ligjore ndaj tij, por nëse i përgjigjet, ai është i barabartë me të gjithë qytetarët. Struktura duhet të ndryshohet, por edhe duhet t'u vazhdohet kontrata, që në radhë të parë përparësinë duhet ta kenë shfrytëzuesit e tanishëm. E përkrah mendimin e Grupit parlamentarë të LDK-së, në radhë të parë ta shfuqizojmë atë vendim dhe kësaj baze t'i fillohet edhe një herë.

**Vala Peshku** u shpreh se po thuhet që këta shfrytëzues të qoshqeve janë raste sociale, por sipas një liste që e posedoj, vërehet se këto në fakt janë biznese, si: NTP "Euro Plast", "Gold Komerc" etj.

Ajo kërkoi të dijë se në bazë të cilit ligj mund t'u vazhdohen kontratat këtyre pronarëve të kioskave, dhe nëse merren këta hapa sipas propozimeve që u dëgjuan, çka do të bëhet më tutje me këta shfrytëzues të qoshqeve.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për anulimin e Vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe, me lokacione sipas planit për vendosjen e tyre.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 11 kundër, u miratua anulimin i Vendimit nr. 01 nr. 360/11-0074230, për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe, me lokacione sipas planit për vendosjen e tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi



Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta